



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VII
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike

Plani i punës së Komisionit për 2020

Tetor 2020
Prishtinë

Nënkryetarja e parë e komisionit
Doruntinë MALOKU - KASTRATI

Hyrje

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe praktikës së punës së Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike (tutje: Komisioni) harton planin e aktiviteteve për vitin 2020. Plani i punës së Komisionit mund të ndryshoj sipas nevojës dhe aktiviteteve të Komisionit.

Komisioni gjatë vitit 2020 si aktivitete kryesore do t'i ketë shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe monitorimin e resorëve të Qeverisë që bien në fushëveprimin e Komisionit, mbikëqyrjen e Agjencioneve të pavarura të fushëveprimit të Komisionit, trajtimin e çështjeve në përmirësimin e mjedisit biznesor, mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit/Kuvendit. Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të angazhojë ekspert dhe do të bashkëpunojë ngushtë me organizatat joqeveritare vendore e ndërkombëtare nga fusha e ekonomisë, punësimit, tregtisë, industrisë etj.

<u>Anëtarët e Komisionit:</u>	<u>Njësia mbështetëse e Komisionit:</u>
	Armend Ademaj, Koordinator i Komisionit
Doruntina MALOKU - KASTRATI Nënkryetare e parë e Komisionit	Muhamet Morina, Zyrtar i lartë i fushës
Zoran MOJSTILOVIÇ Nënkryetar i dytë i Komisionit	Veton Raci, Zyrtar i fushës
Mimoza KUSARI-LILA Anëtare e Komisionit	
Hekuran MURATI Anëtar i Komisionit	
Elbert KRASNIQI Anëtar e Komisionit	
Fidan REKALIU Anëtar i Komisionit	
Memli KRASNIQI Anëtar i Komisionit	
Ferat SHALA Anëtar i Komisionit	
Pal LEKAJ Anëtar i Komisionit	
Adem HODZA Anëtare e Komisionit	

Objektivat e përgjithshme

Komisioni në bazë të mandatit të tij brenda këtij viti do të angazhohet që të realizoj objektivat e veta, në aktivitetet si:

- Shqyrtimin e projektligjeve;
- Hartimi i nismave legislative – (amendamenti i Ligjit për Investimet Strategjike dhe Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.);
- Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit – çështje të caktuara që rregullon ligji,
- Mbikëqyrja e punës së ministrisë/Qeverisë – në baza tremujore;
- Monitorimi i Ndërmarrjeve Publike Qendrore si dhe monitorimi i Ndërmarrjes “Trepça” SHA;
- Monitorimi dhe mbështetja e politikave gjinore në çështjet që trajtohen në komision;
- Monitorimi i zbatimit të MSA-së dhe Agjendës ERA;
- Monitorimi i agjencive të pavarura që i raportojnë drejtpërdrejt komisionit;
- Monitorimi i agjencive ekzekutive në kuadër të ministrisë;
- Monitorimi i zbatimit të Marrëveshjeve tregtare në mes të Kosovës dhe Shqipërisë – mbajtja e mbledhjeve të përbashkëta me komisionin homolog të Kuvendit të Shqipërisë; si dhe Marrëveshjeve tregtare me vendet tjera;
- Monitorimi i zbatimit të Marrëveshjeve në kuadër të dialogut Kosovë- Serbi;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë me komisione homologe;
- Vizita në terren për informata të dorës së parë nga gjendja në terren nga fushe veprimtaria e Komisionit;
- Takime me studentë dhe të diplomuar, me institucionet përgjegjëse për kurrikula me MASHT dhe me Agjencinë e Statistikave, lidhur me harmonizimin e shkollimit me nevojat e tregut të punës;
- Bashkëpunimi me odat dhe asociacionet ekonomike dhe që mbështetin biznesin;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe donatorët.

Rregulla për organizimin e brendshëm

Më poshtë janë të listuara rregullat e përgjithshme për organizimin e brendshëm të Komisionit:

- Komisioni ndërtohet dhe funksionon në bazë të rregullores së Kuvendit;
- Dispozitat që rregullojnë kryesimin e Kuvendit janë bazë edhe për kryesimin e Komisionit;
- Komisioni ka Kryetarin dhe dy nënkryetarë;
- Komisioni ka stafin koordinues (Njësinë mbështetëse);
- Komisioni me dy të tretat e votave, mund të krijojë një ose dy nën-komisione;
- Komisioni për punë apo fusha të caktuara mund të krijojë grupe punuese;

- Nën-komisionet dhe grupet punuese i raportojnë Komisionit;
- Komisioni mund ti caktojë anëtarët e tij si raportues për një çështje ose fushë të caktuar;
- Mbledhjet e Komisionit i thirr dhe i kryeson kryetari, ose në mungesë të tij zëvendëskryetari;
- Mbledhjen e Komisionit mund ta thërrasin edhe një e treta e anëtarëve të Komisionit;
- Komisioni vendos me konsensus ose me shumicë votash;
- Deputeti që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës ka të drejtë t'i bashkëngjisë qëndrimin e vet raportit të Komisionit;
- Mbledhjet e Komisionit janë të hapura, përpos kur Komisioni vendos ndryshe;
- Në mbledhje të komisionit mund të ftohen dhe të marrin pjesë përfaqësues të Qeverisë, përkatësisht ministrisë përkatëse, përfaqësues të institucioneve dhe asociacioneve të interesuara vendore e ndërkombëtare;
- Në punën e Komisionit mund të angazhohen edhe këshilltarë ekspert, në pajtim me udhëzimet procedurale e financiare
- Komisioni në punën e tij mund të shfrytëzojë edhe ndihmën e ekspertëve, institucioneve dhe asociacioneve ndërkombëtare.

Organizimi i brendshëm i Komisionit

Kryetari

Drejton dhe koordinon punën e gjithëmbarshme të Komisionit në bashkëpunim me zëvendëskryetarët; Përfaqëson Komisionin, vetëm ose së bashku me zëvendëskryetarët dhe anëtarët e komisionit, varësisht nga natyra e përfaqësimit; Raporton para Kuvendit për punën e Komisionit dhe paraqet qëndrimet e Komisionit; Për çështje të caktuara mund ta autorizojë zëvendëskryetarët ose anëtarët raportues që të paraqesin qëndrimet e Komisionit.

Zëvendëskryetarët

Ndihmojnë kryetarin e Komisionit dhe e zëvendësojnë atë, kur ai mungon; Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit mbikëqyrin punën e grupeve punuese ose anëtarëve raportues për çështje ose fusha të caktuara, sipas vendimit të Komisionit; Në marrëveshje me Kryetarin e Komisionit paraqesin qëndrimet e Komisionit para Kuvendit; Mbikëqyrin zbatimin e Planit të Punës së Komisionit dhe raportojnë në komision çdo tre muaj;

Raportuesi

Anëtarët e komisionit mund të angazhohen për të raportuar për një çështje të caktuar, apo për të mbuluar dhe hulumtuar një fushë të caktuar dhe për t'i raportuar lidhur me të Komisionit; Me pëlqim të Komisionit dhe Kryetarit të tij, raportuesi mund t'i paraqesë qëndrimet e Komisionit edhe para Kuvendit.

Plani i punës i Komisionit për 2020

Periudha	Agjenda e Komisionit	Detyrat e Komisionit
Shkurt	Konstituimi i Komisionit.	Komisioni.
Mars	Shqyrtimi i Planit të Punës për vitin 2020	Komisioni/Stafi mbështetës harton draftin e parë.
Prill	////////////////////////////////////	Për shkak të Pandemisë COVID 2020 komisioni nuk zhvilloj aktivitete.
Maj	Shqyrtimi i Raporteve të agjencive të pavarura.	Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
Qershor	Shqyrtimi i Raporteve të agjencive të pavarura.	Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
Qershor	Zhvillimi i procesit të intervistimit për bordin e KOSTT-it.	Komisioni i rekomandon Kuvendit zgjidhjen e bordit.
Korrik	Zhvillimi i procesit të intervistimit për Kryesuesin e Komisionit Shqyrtues të ARRU-s.	Komisioni i rekomandon Kuvendit zgjidhjen e Kryesuesit.
Gusht	///	///
Shtator	Shqyrtimi i Raporteve të agjencive të pavarura.	Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
Tetor	Zhvillimi i procesit të intervistimit për plotësimin e bordit të KOSTT-it.	Komisioni i rekomandon Kuvendit plotësimin e bordit.
Tetor	Zhvillimi i procesit të intervistimit për Kryesuesin e Komisionit Shqyrtues të ARRU-s – ri shpallje.	Komisioni i rekomandon Kuvendit zgjidhjen e Kryesuesit.

Tetor	Vizitë në ZRRE	Komisioni realizon vizitë ne terren.
Tetor	<p>Shqyrtimi i projektligjeve të parapara në Programin Legjislativ të Qeverisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social; 2. Projektligjin për Inspektoratin e Punës; 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Lidhje me Transaksionet Elektronike; 4. Projektligji i Punës; 5. Projektligji për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror; 6. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuar nga shteti; 7. Projektligji për Turizëm; 8. Projektligji për Inspektime; 9. Projektligji për Tregtinë me Naftë dhe Produkte të Naftës në Kosovë; 10. Projektligji për Zonat Ekonomike; 11. Shqyrtimi i Projektligjit për Masat për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë; 12. Projektligji për Amandamentimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të Cilat Ekziston e Drejta Banesore dhe Ligjin Nr. 04/L-247, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-061, për Shitjen e Banesave për të Cilat Ekziston e Drejta Banesore; 13. Projektligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes; 14. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e 	Komisioni Amendamentim/Rekomandim.

	<p>Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;</p> <p>15. Projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;</p> <p>16. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;</p> <p>17. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina;</p> <p>18. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore;</p> <p>19. Projektligji për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;</p> <p>20. Projektligji për Odat e Arkitekteve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit;</p>	
Nëntor	<p>Shqyrtimi i projektligjeve të parapara në Programin Legjislativ të Qeverisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Projektligji për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; 2. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-197 për Kimikate; 3. Projektligji për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës; 4. Projektligji për Mbeturinat nga Industria e Nxjerrjes së Mineraleve; 5. Projektligji për Konkurrencën; 6. Projektligji për Patenta; 7. Projektligji për Marka Tregtare; 8. Projektligji për Sekretin Tregtar; 9. Projektligji për Rezervat e Obligueshme të Naftës; 	Komisioni Amendamentim/Rekomandim.
Nëntor	Vizitë bizneseve vendore dhe NP.	Komisioni realizon vizitë ne terren.

Nëntor	Realizimi i projekteve të vitit 2020 dhe prioritetet për vitin 2020 – raportim i ministres dhe agjencitë e pavarura.	Komisioni fton ne seancë dëgjimore ministren dhe bordet në seancë dëgjimore.
Dhjetor	Shqyrtimi i projektligjeve të parapara në Programin Legjislativ të Qeverisë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Projektligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme; 2. Projektligji për Ndërmarrje Publike; 3. Projektligji për Tregti të Brendshme; 4. Projektligji për tregti të jashtme; 5. Projektligji për Dizajn Industrial; 6. Projektligji për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë dhe Qarqeve të Integruara 7. Projektligji për Shërbime Sociale; 8. Projektligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi; 9. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-119 për Produktet Biocide; 10. Projektligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma; 	Komisioni Amendamentim/Rekomandim.
Dhjetor	Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2021 të Ministrisë dhe Institucioneve të pavarura.	Komisioni mban dëgjim me Ministrinë e linjës dhe Agjencionet e pavarura.
Dhjetor	Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2020.	Komisioni/Stafi mbështetës.

Përgatitur nga:
Njësia mbështetëse e Komisionit
Tetor 2020
Prishtinë

Nënkryetarja e parë e Komisionit
Doruntinë MALOKU - KASTRATI